LIGJ
Nr.8423, datë 7.12.1998

PËR RATIFIKIMIN E "LETRËS SË GARANCISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KUADRIN E MARRËVESHJES SË HUASË, FINANCIMIT DHE PROJEKTIT ME KFW-NË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMEVE TË KRUJËS"

Në mbështetje të neneve 121 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Letra e Garancisë, lëshuar nga Republika e Shqipërisë, në kuadrin e marrëveshjes së huasë, financimit dhe projektit me KfW-në, për financimin e projektit të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve të Krujës.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2264, datë 17.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërië, Rexhep Meidani

Letër garancie
E datës 26.3.1998

Nga
Republika e Shqipërisë
e përfaqësuar nga Ministria e Financave

Lidhur me Marrëveshjen e Kanalizimit
Midis
Bankës së Shqipërisë, Tiranë
dhe
Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, Krujë

Për shumën
2 100 000 00 DM

Nëpërmjet Marrëveshjes së Kanalizimit të datës ___, BSh ka marrë përsipër të kanalizojë në Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve, Krujë, një hua që nuk kalon shumën 2 100 000 00 Dm

Me kusht që Garantuesi të lëshojë një letër garancie për pagesën e detyrimeve të nënhuaamarërsit sipas marrëveshjes së kanalizimit, si më poshtë:

1. Garantuesi, bie dakord për të gjitha dispozitat e marrëveshjes së kanalizimit dhe jep të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e asaj marrëveshjeje.

2.1 Duke hequr dorë nga të gjitha kundërshtimet ndaj marrëveshjes së kanalizimit, garantuesi jep një garanci të pavarur dhe të parevokueshme për BSh për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të pagesës.

2.2 Sipas rastit, garantuesi, do të bëjë ndonjë dhe të gjitha pagesat e detyruara nga

nënhuamarrësi sipas marrëveshjes së kanalizimit pa vonesë me kërkesën e BSH nëse këto pagesa nuk janë bërë nga nënhuamarrësi kur duhej. Detyrimi për pagesë i garantuesit nuk do të varet nga lajmërimi i parë i BSH ose i kërkesës së saj për të bërë pagesën nënhumarrësit ose në ngritjen e një padie ose marrjen e hapave të tjerë kundër nënhuamarrësit ose në provimin nga BSH se humarrësi nuk ka paguar.

2.3 Garantuesi do t'i bëjë të gjitha në Dm në BSh në llogarinë ____, duke mos u lejuar tërheqje mbrapsht ose kundërreklamime ndaj këtyre pagesave.

3. Ndryshimet në marrëveshjen e kanalizimit do të bëhen me pëlqimin e garantuesit vetëm nëse dhe deri në atë shkallë që ato prekin pagesën e detyrimeve të garantuara në paragrafët 2.1, 2.2 dhe 2.3.

Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministri i Financave
Arben Malaj